

VENDIM
Nr.527, datë 23.4.2008

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.512, DATË 31.5.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PROCEDURAT E KRYERJES SË KONTROLLIT TË NDIHMËS
EKONOMIKE, TË PAGESËS SË AFTËSISË SË KUFIZUAR DHE SHËRBIMEVE
SHOQËRORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 27 të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 7 të kreut II të vendimit nr.512, datë 31.5.2006 të Këshillit të Ministrave të shtohen pikat 8 e 9, me këtë përmbajtje:

“8. Inspektorati i Ndihmës Ekonomike, Pagesës për Persona me Aftësi të Kufizuar dhe Shërbimeve Shoqërore, në nivel qendror dhe rajonal, kontrollon saktësinë e informacionit, në këto institucione, në:

- a) zyrën e punës, për të vërtetuar nëse përfituesi është i punësuar/punëkërkues i papunë;
- b) zyrën e tatim-taksave, nëse janë subjekte të regjistruara në këto organe;
- c) zyrën e Inspektoratit Shtetëror të Punës, nëse nga aktet e inspektimit rezulton se janë punësuar informalisht;
- ç) zyrën e sigurimeve shoqërore, nëse përfiton pension pleqërie/familjar apo është kontribues në skemën e sigurimit vullnetar;
- d) zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, nëse kanë në pronësi pasuri të paluajtshme;
- dh) zyrën e regjistrimit të automjeteve, nëse kanë mjete/automjete motorike;
- e) seksionet pranë bashkive/komunave si në atë të urbanistikës, të tregut të lirë, transportit, kulturës dhe energjetikës, nëse janë subjekte të regjistruara pranë tyre.

9. Kur Inspektorati i Ndihmës Ekonomike, Pagesës për Persona me Aftësi të Kufizuar dhe Shërbimeve Shoqërore, në nivel qendror dhe rajonal, vëren mospërputhje të informacionit të dërguar në njësinë e qeverisjes vendore me informacionin e kontrolluar në institucionet e përmendura në pikën 1, i paraqet drejtuesit të institucionit propozimin për marrjen e masave të mëposhtme për personat përgjegjës:

- a) gjobë, sipas neneve 5 e 6 të ligjit nr.7697, datë 7.4.1993 “Për kundërvajtjet administrative”;
- b) vërejtje me shkrim;
- c) propozim për largim nga puna;
- ç) propozim për fillimin e procedurave nga autoriteti përgjegjës, në rastet kur mendohet se janë konsumuar elementet e veprës penale ose të kundërvajtjes penale.”.

2. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha